



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Nëvia org. Org. jedinica Org. Unit	ARPL
Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	04
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	997-2/24
Data: Datum: Date:	15.03.24
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	19.03.2024
REFERENC-Ë:	997/24 - ZSP- ARPL/ 2024
PËR/ZA/TO:	„BALLKAN PETROL“ Sh.p.k. Zona Industriale Gërlicë, K. Ferizaj
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH	Z. Izedin BYTYQI, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së Z. Naser AFIZI, Zëvendësues i drejtorit të ARPL-së Znj. Makfirete DIBRANI, Udhëheqëse e DMRU-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të drejtën ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Leje Ujore, Shkarkim

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën, me Nr. të prot: 997/24, me datë 16.02.2024, për shkarkim të ujërave të ndotura nga fabrika për prodhim -homogjenizim të vajrave në Gërlicë të Ultë, K.Ferizaj dhe ka vendosur si në Vendim për Leje Ujore, të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

L.U.

Datë: 19.03.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjensive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e palës „Ballkan Petrol” Sh.p.k. K. Ferizaj, me Nr. prot. 997/24, datë për **LEJE UJORE** për shkarkim e ujërave të ndotura nga fabrika për prodhim – homogjenizim të vajrave, në Gërlicë të Ultës, K.Ferizaj, Impianti me koordinata: (X=7 516 148.00; Y=4 684 125.58), në Ngas. P-72217029-00362-1, sipas kushteve vijuese:

1. Leja Ujore lëshohet në bazë të dokumentacionit tekniko - investiv për shkarkimin e ujërave nga fabrika për prodhim – homogjenizim të vajrave minerale ;
2. Afati i lëshimit të lejes ujore është 5 (pesë) vite, me mundësi zgjatjeje sipas kërkesës së palës;
3. Analiza dhe përcaktimi i parametrave standard e projektues, kualitativ dhe kuantitativ (temperatura, pH, SHBOs, SHKO, sasia materieve të suspenduara, baktereve e ngjashëm) të përcaktuar me legjislacionin në fuqi, paratrajtimi për specifikat e recipientit, duhet prezantuar në MMPHI;
4. Objektet me destinim të grumbullimit, trajtimit të ujërave të ndotur dhe llumit dhe ato të shkarkimit, duhet të mirëmbahen rregullisht dhe të shfrytëzohen në atë mënyrë që të sigurojnë funksionalitet të plotë;

5. Nëse gjatë operimit vije deri të ndryshimi i regjimit të ujërave dhe shkaktimit të dëmeve eventuale mjedisit, ose palëve të treta, investitori është i obliguar që dëmet t'i evitoj dhe të njejëtat t'i kompensoj;
6. Që të kryhet monitorimi në të gjitha fazat e trajtimit të efluentit sipas destinimit të veçant, rezultatet e monitorimit të raportohen në MMPHI/ARPL çdo gjasht muaj;
7. Obligimi financiar lidhur me shkarkimin e ujërave të ndotura, do të caktohet me vendim të posaçëm, në rast se analizat e ujit nuk i plotësojnë kriteret sipas U.A. MMPH -Nr. 02/2022 për kushtet, mënyra, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor";
8. Të drejtat e fituara në bazë të Lejes Ujqore nuk mund t'u barten personave të tretë, pa pajtimin e organit i cili ka lëshuar këtë Leje Ujqore;
9. Për vazhdimin e Lejes Ujqore bartësi është i obliguar që të aplikoj se paku 2 (dy) muaj para skadimit të afatit të Lejes Ujqore;
10. Validiteti i Lejes Ujqore pushon në rast të mos plotësimit të kushteve të lartcekura në afatet e parapara kohore.

ARSYETIM

Zyrtarët përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujqore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim: "Elaborati dhe dokumentacioni investivo - teknik për leje ujqore për shkarkim e ujërave të ndotura nga fabrikën e prodhimit – Homogjenizim të vajrave Minerale në Gërlicë të Ulët, Komuna Ferizaj; Marrëveshja e bashkpunimit, ne mes te "Ballkan Petrol" dhe "Ina Construction" për hartimin dhe Përpilimin e Elaboratit për leje ujqore për shkarkim; Procesi i punës dhe procesi teknologjik i prodhimit të vajrave dhe fluideve; sasia e ujërave të shkarkuara nga kompania, sipas specifikacioneve të vepromtarisë si : llogartija e ujërave nga administrata për punëtor; Llogaritja nga pastrimi i dyshemeve; Llogaritja e ujërave të shkarkuara nga rreshjet atmosferike; Certifikata e Biznesit të kompanisë Ballkan Petrol sh.p.k. (810080036); Licencë e Gjeodetit të licencuar, Shkumbin Aliu, Numri i Leicences :43; Situacioni i terenit, në përjesë 1: 2500, ashtu siq kërkohet me U.A 03/2018 për procedurat për leje ujqore, si dhe i njejëti në kombinim me orto – foto; vendim për dhënjen e Certifikatës së legalizimit, nr i references: 04-351/02-0010880/21, lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit, K. Ferizaj; vendim për Pëlqim Mjedisor lidhur me projektin për prodhimin – Homogjenizimin e vajrave Menerale në Gërlicë, me Nr: 07/2047/ -ZSP-1540; datë 03.10.2007; Pëlqim mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjarri për nxerrje te lejes ndertimore , me nr 27/03; Certifikata e pronësisë ,me nr P-72217029-00362-1; Kopje Plani për nr 00362-0; certifikata e regjistrimit të biznesit të kompanisë hartuese"INA CONSULTING " Sh.p.k. (811303099), Diplomë e Saranda Nebi Hotit; Diplomë e Esat Bislim Mehani, gjeolog; pala dokumentacionit ia ka bashkangjitur edhe faturat e pagesave me rastine aplikimit , sipas shtojces 6 të U.a 03/2018, për (K.U. ; L.U.) në vlerë prej 300 € si dhe për pëlqim P.U.; në vlerë prej 500 €; , si dhe CD-në; Andaj bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, bazuar në shikimin në vend, datë 14.03.2023, me çrast është vizituar Impianti i trajtimit në piken koordinative, meqe uji nuk përdoret fare për prodhim, shkarkimi nuk perzihet me vajra, sipas projektit të dorëzuar, kapaciteti i pranimit është 10 - 12m³/ditë i cili i plotëson kushtet për trajtim

ditor të shkarkimit të ujërave të ndotura nga fabrika e cila ka kapacitetin maksimal ditor 6-7m³/dit, me që uji nuk përdoret fare për proces teknologjik, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr: 997/23 -ZSP- 2024, Datë: 19.03.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës Ferizaj;
- Arkivit të Ministrisë.

Zavënedësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së



Ledin BYTYQI